

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**



**RAPORT
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E PLANEVE VENDORE TË
POLICIMIT, TË SIGURISË NË KOMUNITET DHE NISMAT E
POLICIMIT NË KOMUNITET**

Nr. 8/2018

Prishtinë, 19 shkurt 2019

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit mbi menaxhimin e planeve vendore të policimit, të sigurisë në komunitet dhe nismat e policimit në komunitet
Data e përgatitjes	19 shkurt 2019
Përgatitur nga	Linda Ahmeti, udhëheqëse e ekipit të inspektimit, Kadri Keçmezi, inspektor, Mirsad Puçurica, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Miradije Kelmendi, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	19 shkurt 2019



1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(5-5)

2. Hyrje

- 2.1 Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2 Qëllimi i inspektimit.....(6-6)
- 2.3 Objekti i inspektimit.....(6-6)
- 2.4 Subjekti i inspektimit.....(6-6)
- 2.5 Objektivat e inspektimit.....(7-7)
- 2.6 Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7 Metodologjia e inspektimit.....(7-7)
- 2.8 Periudha e kryerjes së inspektimit.....(7-7)
- 2.9 Periudha e mbulimit të inspektimit.....(7-7)
- 2.10 Drejtimet e inspektimit.....(8-8)
- 2.11 Kriteret e vlerësimit.....(8-8)
- 2.12 Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(8-8)

3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1 Avancimi i reformave organizative në kuadër të stacioneve.....(9-13)
- 3.2 Planet policore dhe raportet analitike për sigurinë në komunitet.....(14-16)
- 3.3 Performanca e stacioneve në ngritjen e sigurisë në komunitet.....(17-22)
- 3.4 Fuqizimi dhe avancimi i partneritetit me komunitetin.....(22-25)
- 3.5 Kushtet teknike dhe logjistike në stacione policore.....(25-26)

4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(27-28)

Shtojca

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Lidhur me reformat organizative që lidhen me zbatimin e konceptit të policimit në bashkësi, Policia e Kosovës ka realizuar transformimin organizativ siç e parasheh Strategjia për policimin në bashkësi. Me qëllim të arritjes së objektivave strategjike, në stacionet të kategorisë A në pajtim me strukturën organizative policore dhe Procedurën Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e Policisë së Kosovës për policim në komunitet, që në pikën 4 parasheh kriteret bazë për ndarjen e sektorëve¹, Policia ka bërë ndarjen në sektorë² të zonave të përgjegjësisë së stacioneve policore. Tek disa stacione ndarja sektoriale konsiderohet e qëndrueshme, derisa disa tjera janë në fazën e rishikimit të tyre bazuar në kriteret bazë që ndikojnë në ndarje sektoriale. Sektorët janë duke u ballafaquar me mungesë personeli, për dallim me atë që e përcakton Lista e Autorizuar e Personelit. Standardi i përcaktuar për qëndrim të zyrtarëve policor për së paku dy (2) vite në kuadër të sektorit, del të jetë i sfiduar për shkak të lëvizjes të personelit. Hapja e zyreve kontaktuese nëpër zonat rurale po përcillet me pengesa të natyrave të ndryshme, me gjithë faktin se disa nga sektorët e stacioneve policore kanë arritur të hapin disa prej tyre. Dosjet sektoriale janë duke u konsoliduar, pasi tek to janë gjetur mangësi informatash, me çka nevojitet një angazhim dhe koordinim në mes të njëjësive dhe institucioneve. Stacionet policore duhet të angazhohen edhe në krijimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve në sektorë mbi personat e dyshimtë që ndërlihen me ekstremizëm dhe radikalizëm.

1.1.2. Lidhur me nxjerrjen dhe realizimin e planeve operative të stacioneve policore, numri i tyre për dy vitet është pothuajse i balancuar, por ka dallime të mëdha sa i përket numrit të tyre varësisht nga stacionet edhe pse i takojnë të njejtës kategori. Stacionet ende praktikojnë raportimin nga terreni përmes C1, si një formë e raportimit të aktiviteteve të dyshimta që nga periudha e administrimit të Policisë së UNMIK-ut. Stacionet duhet të realizojnë konceptin siç e parasheh Strategjia - Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca dhe Procedura Standarde e Operimit për Detyrat e zyrtarit policor në procesin e inteligjencës, në përdorimin e raporteve informuese dhe atyre të inteligjencës. Inspektimi tregon se stacionet policore hartojnë raporte analitike ku paraqesin shtrirjen e veprimtarisë kriminale, identifikimin e pikave të nxehta, kohën, identifikimin e të dyshuarve të vepra kriminale, mënyrën e kryerjes së veprës, në mënyrë që zyrtarët policor në stacionet policore të kenë një pasqyrë më të mirë për planifikimet dhe qasjen në zonat e identifikuara. Raportet vjetore të stacioneve janë analizuar dhe në përgjithësi informatat përcillen zinxhir në hierarkinë e stacionit.

1.1.3. Policia ka avansuar në mënyrën e mbledhjes së të dhënave mbi trendët e krimit dhe kjo bën që periodikisht të maten dhe krahasohen indikatorët e nivelit të krimit, por edhe performanca në

¹ Kriteret bazë për ndarjen e sektorëve policor janë: trendi dhe llojet e krimeve; dukuritë negative dhe shkalla e rrezikshmërisë së jetës, mirëqenies dhe pronës së qytetarëve dhe publikut; numri objekteve vitale me dedikim publik, ekonomik, shtetëror, historik, fetar, etj; karakteristikat territoriale, pozita gjeografike dhe rëndësia e tyre nga niveli i sigurisë; shkalla e urbanizmit dhe zhvillimit ekonomik dhe industrial; niveli i zhvillimit të komunikacionit dhe turizmit; faktori demografik; faktori etnik dhe religjioz, etj.

² Sipas Procedurës Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e Policisë së Kosovës për policim në komunitet, sektori policor nënkupton një pjesë të caktuar të një territori brenda kufijve të një apo më shumë bashkësive lokale në territorin e komunës, në të cilin një numër i caktuar i zyrtarëve policorë kryejnë të gjitha detyrat policore lidhur me sigurinë e përgjithëshme të komunitetit.

parandalimin dhe luftimin e krimit. Nëse e shikojmë nga këndvështrimi i synimeve policore për ulje të numrit të rasteve dhe ngritje të zbulueshmërisë së tyre, del se në nivel të përgjithshëm të stacioneve policore të kategorisë A, rastet penale dhe incidentet në vitin 2017 kanë shënuar rënie në njërën anë krahasuar me vitin paraprak, ndërsa rënie ka shënuar edhe zbulueshmëria e rasteve në krahasim me vitin 2016, që paraqet një indikator në kah të kundërt me synimet. Stacionet policore janë ballafaqur më shumë me veprat penale kundër pasurisë. Shumica e stacioneve të kategorisë A nevojitet që në ardhmen të sigurojnë dhe të mbajnë evidencat mbi përcaktimin dhe trajtimin e rasteve me prioritet. Masat pro - aktive të ndërmarra nga stacionet në vitin 2017 në ngritjen e sigurisë rrugore pasqyrojnë se përgjithësisht stacionet kanë rezultuar me rënie të numrit të aksidenteve krahasuar me vitin 2016. Të dhënat pasqyrojnë rënie të numrit të ekzekutimit të urdhëresave të gjykatave dhe në këtë drejtim stacionet policore duhet të analizojnë faktorët që kanë ndikuar në këtë performancë. Të dhënat mbi asistimet pasqyrojnë se stacionet vazhdojnë të jenë të ngarkuara me angazhime në dhënien e asistencës për institucione publike dhe private, me çka shihet e nevojshme të bëhet rishikimi i këtyre politikave, drejt fuqizimit të punës sektoriale.

1.1.4. Në drejtim të avansimit dhe fuqizimit të partneritetit me komunitetin, stacionet janë përfshirë në aktivitete me drejtoritë komunale të arsimit, këshillat e shkollave dhe prindërve. Stacionet policore duhet të punojnë në përgatitjen e trajnerëve në nivel lokal për të ligjëruar në shkolla siç e parasheh Strategjia dhe Plani i Veprimit (Policia në Bashkësi). Vlerësohet se gjendja e përgjithshme e funksionimit të Këshillave Lokale për Siguri Publike (KLSP) është jo e kënaqshme. Ka kërkesa për themelimin e KLSP-ve të reja, kurse lidhur me ato ekzistueset, po paraqiten probleme rreth mos interesimit të anëtarëve të tyre, për shkak të moskompensimit apo stimulimit për angazhimin e tyre.

1.1.5. Me gjithë faktin që për implementimin e punës sektoriale nevojiten kushte pune, në praktikë del se stacionet policore ballafaqohen me probleme të shumta të natyrës teknike dhe logjistike. Vërehen mungesa të hapësirave për punë dhe pajisjeve teknike (kompjuterë, aparate fotografike, matës të shpejtësisë së lëvizjes, alkooteste, printerë, etj). Problematikë në vete është edhe mungesa e automjeteve policore, që konsiderohen të domosdoshme për punë efikase në sektorë policorë. Mungesa e kushteve për punë është një temë e kahershme dhe kjo gjendje duhet trajtuar në drejtim të përmirësimit të kushteve, qoftë hapësirave për punë, pajisjeve teknike dhe automjeteve.

1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga (...) rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar (inspektimi nr. ../.....), ... (..) prej tyre është realizuar plotësisht, ... (..) janë realizuar në masë të madhe (përgjithësisht), ... (..) janë realizuar pjesërisht dhe ... (..) nuk janë realizuar fare (për më tepër referoju tabelës në shtojcën I).

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik e të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit të IPK-së për vitin 2018 ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit policor, përfshirë edhe atë të menaxhimit të planeve vendore të policimit, të sigurisë në komunitet dhe nismat e policimit në komunitet. Inspektimi i kësaj fushe paraqet interes për IPK-në me qëllim që të vlerësohet se Policia është e orientuar që sa më mirë t’iu ofrojë siguri qytetarëve, duke kryer detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj. Është më rëndësi të konstatohet se zbatimi i konceptit të policimit në bashkësi nga Policia, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e besimit dhe të bashkëpunimit të qytetarëve, si dhe vetëdijesimin e tyre për të ndihmuar atë në krijimin e një ambienti më të sigurt. Policia ka hartuar edhe Strategjinë e dytë për policimin në bashkësi, që ofron një frymë të re dhe koncept policimi, bazuar në bashkëpunimin me komunitet, përfshirë, institucionet, forumet e sigurisë dhe qytetarët. Është kjo filozofi me synim të kalimit nga qasja reaktive, në atë pro-aktive të luftimit të krimit, drejt krijimit të një mjedisi më të sigurt. Inspektimi paraqet një instrument për të vlerësuar realizimin e synimeve. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 13 gusht 2018, mbi bazën e Programit të të punës inspektuese, ka iniciuar inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë.

2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saja;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat;
- Që të jepet një mendim objektiv mbi çështjet që lidhen me planet e policimit, sigurinë dhe nismat në komunitet;
- Që të identifikojë mangësitë, dobësitë dhe rekomandojë masa adekuate për funksionim më të mirë policor.

2.3. Objekti i inspektimit

2.3.1. Në këtë inspektim të rregullt është vlerësuar ”menaxhimi i planeve vendore të policimit, të sigurisë në komunitet dhe nismat e policimit në komunitet”.

2.4. Subjekti i inspektimit

2.4.1. Inspektimi është përqendruar kryesisht në stacionet policore të kategorisë A, në kuadër të Divizionit për Siguri Publike të Departamentit për Operacione të Policisë së Kosovës.

2.5. Objektivat e inspektimit

2.5.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i organizimit, funksionimit dhe kapaciteteve të burimeve njerëzore e teknike;
- Vlerësimi i menaxhimit të planeve të policimit, të sigurisë në komunitet dhe nismat e policimit në komunitet;
- Vlerësimi i performancës së stacioneve në fushën e hetimit dhe zbulimit të krimit;
- Vlerësimi i përmbushjes së detyrave operative në fushën e sigurisë publike dhe rrugore;
- Vlerësimi i realizimit të objektivave dhe detyrave që dalin nga strategjitë policore;
- Vlerësimi i funksionimit të shërbimeve logjistike në funksion të stacioneve policore.

2.6. Rëndësia e inspektimit

2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ndërmarrjen e masave të nevojshme drejt përmbushjes së planeve të veprimit që lidhen me Strategjinë për policimin në bashkësi dhe strategjitë tjera të ndërlidhura;
- Ngritjen e vetëdijes policore mbi nevojën e ngritjes së bashkëpunimit me komunitetin;
- Ngritjen e performancës policore, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në punë;
- Nxitjen e bashkëpunimit polici - komunitet në përmirësimin e klimës së sigurisë.

2.7. Metodologjia e inspektimit

2.7.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar takime dhe intervista me drejtues dhe punonjës të stacioneve të kategorisë A (Komandantët, Shefat e Operativës, Shefat e Hetimeve dhe Zyrtarët e Komunitetit);
- b) Janë kryer kontrole të: ambienteve të punës së stacioneve, dosjeve sektoriale, planeve dhe raporteve analitike periodike, si dhe mjeteve të punës;
- c) Janë plotësuar formularët e inspektimit për vlerësimin e përmbajtjes së evidencave të dosjeve sektoriale në stacione policore;
- d) Janë marrë dokumente, si: raportet vjetore të Drejtorisë për Policimin në Bashkësi dhe Parandalim, raportet vjetore mbi aktivitetet e stacioneve, raportet periodike të stacioneve mbi implementimin e Strategjisë, planet të policimit dhe raportet analitike, raportet mbi infrastrukturën teknike të stacioneve, dëshmi tjera që lidhen me policimin në bashkësi.

2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit

2.8.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 27.08.2018 dhe ka përfunduar me datë 10.09.2018.

2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit

2.9.1. Inspektimi është përqëndruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave gjatë periudhës dy vjeçare (2016-2017) dhe gjendjen aktuale të kësaj fushe.

2.10. Drejtimet e inspektimit

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Avancimi i reformave të brendshme organizative në kuadër të stacioneve policore;
- Planet policore dhe raportet analitike për sigurinë në komunitet;
- Performanca e stacioneve policore në ngritjen e sigurisë në komunitet;
- Fuqizimi dhe avancimi i partneritetit me komunitetin;
- Kushtet teknike dhe logjistike në stacione policore.

2.11. Kriteret (standardet) e vlerësimit

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave në stacionet policore:

- Ligji i Policisë;
- Rregullorja për Operativë në Policinë e Kosovës;
- Procedura Standarde e Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe Metodologjinë e Policisë së Kosovës për policim në komunitet;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit (Policia në Bashkësi) 2017-2021;
- Plani Zhvillimor Strategjik (2016-2020).

2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave

2.12.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese.

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Avancimi i reformave të brendshme organizative në kuadër të stacioneve policore

3.1.1. Me qasjen e re policore me elementin e policimit në komunitet dhe ndarjen sektoriale, Policia synon të ofrojë siguri, shërbim efikas dhe efektiv për qytetarët, përmes metodave dhe praktikave të avancuara demokratike të veprimtarisë policore. Këto aktivitete janë bazuar në një sërë dokumentesh ligjore e strategjike, përfshirë: Ligjin për Policinë, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, Rregulloren për Personel dhe Administratë, Rregulloren për Operativë, Procedurën Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë për policimin në komunitet, si dhe Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Policim në Bashkësi. IPK vlerëson nxjerrjen e rregullativës ligjore për kryerjen e aktiviteteve në sektorë. Nga intervistat e zhvilluara me zyrtarë policor vërehet se kanë njohuri dhe janë të njohur me infrastrukturën ligjore primare, sekondare dhe Procedurat Standarde të Operimit, të cilat janë të vendosura në intranet në faqen zyrtare, në të cilën ka qasje çdo zyrtar dhe se ata me kohë njoftohen për çdo ndryshim në të. Synimi i parë i Strategjisë dhe Planit të Veprimit (Transformimi organizativ) mbi nxjerrjen e rregullativës ligjore organizative që konsiston në hartimin dhe përshtatjen e Procedurave të reja Standarde të Operimit është përmbushë dhe inkurajohen drejtuesit në vazhdimin e respektimit në praktikë të nenit 11 të Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, mbi njoftimin e zyrtarëve policorë me ligjet dhe aktet nënligjore, me qëllim që personeli policer të jetë i njohur me rregullat dhe procedurat që të performojë sa më profesionalisht dhe në mënyrë efikase dhe efektive.

3.1.2. Policimi në Bashkësi nënkupton filozofinë - strategjinë e organizimit që promovon veprime të bazuara në partneritet dhe bashkëpunim ndërmjet Policisë dhe komunitetit, me qëllim të arritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve nga krimi dhe dukuritë negative, për të përmirësuar cilësinë e jetës për komunitetin. Me qëllim të arritjes së objektivave të Policimit në Bashkësi, në stacionet policore të kategorisë A në pajtueshmëri me strukturën organizative policore dhe Procedurën Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë për policim në komunitet, që në pikën 4 parashihet kriteret bazë për ndarjen e sektorëve³, Policia ka bërë ndarjen në sektorë⁴ të zonave të përgjegjësisë së stacioneve policore. Ndarja e zonës së përgjegjësisë në sektorë caktohet nga Komandanti i Stacionit Policor me aprovimin e Drejtorit Rajonal, varësisht nga specifikat dhe problemet në aspektin e sigurisë në një hapësirë të caktuar sektoriale. Sektorët policorë udhëhiqen nga Koordinatorët në kuadër të Operativës së stacioneve policore. Transformimi organizativ i përcaktuar me Strategjinë - Planin e Veprimit, mbi ndarjen e zonave të përgjegjësisë së stacioneve policore në sektorë patrullues është përmbushur.

³ Kriteret bazë për ndarjen e sektorëve policor janë: trendi dhe llojet e krimeve; dukuritë negative dhe shkalla e rrezikshmërisë së jetës, mirëqenies dhe pronës së qytetarëve dhe publikut; numri objekteve vitale me dedikim publik, ekonomik, shtetëror, historik, fetar, etj; karakteristikat territoriale, pozita gjeografike dhe rëndësia e tyre nga niveli i sigurisë; shkalla e urbanizmit dhe zhvillimit ekonomik dhe industrial; niveli i zhvillimit të komunikacionit dhe turizmit; faktori demografik; faktori etnik dhe religjioz, etj.

⁴ Sipas Procedurës Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e Policisë së Kosovës për policim në komunitet, sektori policor nënkupton një pjesë të caktuar të një territori brenda kufijve të një apo më shumë bashkësive lokale në territorin e komunës, në të cilin një numër i caktuar i zyrtarëve policorë kryejnë të gjitha detyrat policore lidhur me sigurinë e përgjithëshme të komunitetit.

3.1.3. Që nga fillimi i implementimit të metodologjisë së re të punës me konceptin e policimit në komunitet, në stacionet e inspektuara bëhet rishikimi i ndarjeve sektoriale. Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021 (Policia në Bashkësi) në objektivin strategjik 4 që ka të bëjë me avansimin e reformave të brendshme, ka përcaktuar si aktivitete rishikimin e sektorëve policor bazuar në kriteret e themelimit. Sa i përket rishikimit sektorial, disa stacione janë në fazën e analizave dhe vlerësimit për ndryshim apo riorganizim të sektorëve (Mitrovicë - Jugu, Pejë, Prishtinë - Qendra, Prishtinë - Jugu, Mitrovicë - Veriu). Ferizaj vlerëson se ndarja aktuale sektoriale funksionon në mënyrën e duhur. Gjakova vlerëson se nuk ka nevojë për ndryshime sektoriale, me gjithë rishikimin e bërë, pasi nuk ka ndryshime në kriteret bazë të ndarjes sektoriale. Gjilani ka pasur katër (4) sektorë dhe më pas është krijuar edhe sektori i pestë, i cili mbulohet nga Nënstacioni Policor - Zhegër. Prishtinë - Veriu në vitin 2016 ka bërë rishikimin sektorial dhe nga pesë (5) sektorë, është ngritur në shtatë (7) numri i tyre, mirëpo në fillim të vitit 2018, bazuar në nevojat dhe kapacitetet, është reduktuar numri i tyre në katër (4). Stacioni Policor në Prizren me rastin e formimit të Stacionit Policor - Veriu dhe ndarjes së zonës së përgjegjësisë, është bërë rishikimi dhe në bazë të analizave të kryera ka mbetur i njëjtë numri i sektorëve. Leposaviqi ka rishikuar funksionimin e sektorëve dhe në bazë të analizave të bëra, vlerësohet se nevojitet edhe një sektor dhe ka parashtruar kërkesë, me çka është në pritje të një përgjigjeje. IPK-ja inkurajon drejtuesit e stacioneve në kryerjen e analizave vlerësimeve për riorganizim të sektorëve, me qëllim të adresimit të nevojave nga terreni dhe ngritjes së sigurisë në komunitet në nivel edhe më të lartë.

3.1.4. Në mbështetje të sektorëve, me qëllim të përmbushjes së nevojave operacionale që dalin nga Strategjia dhe Plani i Veprimit, në nivel të stacioneve është realizuar funksionimi organizativ dhe janë funksionale të gjitha pozitat organizative, duke filluar nga Komandanti i Stacionit, deri te Zyrtari Policor në sektor. Në mënyrë që Policia të jetë efikase dhe efektive në kryerjen e detyrave të saj, rol me rëndësi luan edhe niveli i disponueshmërisë së burimeve njerëzore në sektorë. Policia ka strukturën e saj të organizimit dhe se në kuadër të saj ka paraparë burime njerëzore për nivelin qendror dhe atë lokal. Inspektimi i realizuar në stacione policore të kategorisë A nxori në pah se struktura organizative dhe Lista e Personelit të Autorizuar për pjesën sektoriale nuk është në përputhje me gjendjen aktuale të personelit të angazhuar në sektorë. Gjendja aktuale e personelit për punë sektoriale në stacionet policore të inspektuara është në shpërputhje me Listën e Autorizuar të Personelit. Sipas Raporteve vjetore të stacioneve policore të kategorisë A, pothuajse të gjitha stacionet kanë mungesë, në përjashtim të Stacionit Policor në Pejë. Me mungesë më të madhe të personelit në sektorë policor ballafaqohet Prishtinë - Jugu, pasuar nga Leposaviqi, Gjakova dhe kështu me radhë. Peja ka tre (3) zyrtarë policor më tepër se që parashihet me skemën për punë sektoriale. Sipas drejtuesve të stacioneve, veç mungesës së personelit për punë sektoriale, sfida tjetër është edhe angazhimi i personelit në aktivitete jopolicore, transferet e policëve nga sektorët në njësi tjera, gradimet, mosha e shtyrë e një numri zyrtarësh të angazhuar në sektorë policorë, zyrtarët me detyra të lehtësuara, zyrtarët policorë me orar të shkurtuar pune, pushimet e lehonisë dhe nevojat tjera operacionale. Stacioni Policor në Prishtinë - Veriu ka 12 zyrtarë policor të angazhuar në sigurimin e Pallatit të Drejtësisë edhe pse me vendime janë të angazhuar për punë në sektorë. Mungesa e kapaciteteve për punë sektoriale, si dhe angazhimi i kapaciteteve aktive ekzistuese në aktivitete të cilësuara si jopolicore ndikojnë dukshëm në rënien e efikasitetit policor në angazhimet sektoriale dhe janë pengesë në realizimin e objektivave strategjike.

Tabela nr. 1 - Të dhëna mbi burimet njerëzore në sektorët policorë të stacioneve të kategorisë A			
Stacionet policore të kategorisë A	Lista e Autorizuar e Personelit	Gjendja aktuale	Ndryshimi (+/-)
Prishtinë - Qendra	48	41	-7
Prishtinë - Jugu	43	16	-27
Prishtinë - Veriu	37	29	-8
Prizren	19	14	-5
Pejë	31	34	+3
Gjilan	35	33	-2
Ferizaj	31	25	-6
Gjakovë	37	22	-15
Mitrovicë - Jugu	30	27	-3
Mitrovicë - Veriu	31	17	-14
Leposaviq	31	13	-18

Rekomandimi nr. 1

IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal dhe Komandantëve të Stacioneve të kategorisë A, që të angazhohen fuqishëm në harmonizimin e numrit të personelit për punë sektoriale me Listen e Autorizuar të Personelit dhe në gjetjen e mundësive të mosangazhimit të personelit në aktivitete jopolicore, që me vendime janë përcaktuar për punë në sektorë, me qëllim që sektorët policorë të jenë më efikas dhe më efektiv në përmbushjen e synimeve strategjike të policimit.

3.1.5. Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017- 2021 (Policia në Bashkësi) në objektivin strategjik 4 që ka të bëjë me avansimin e reformave të brendshme, konkretisht në objektivin 4.1 (Fuqizimi i sektorëve policor) përcakton zbatimin e standardit për qëndrim së paku dy (2) vjeçar të zyrtarëve policor në sektorë policor. Inspektimi vë në pah se Policia është sfiduar nga realizimi i këtij standardi për shkaqe të ndryshme, përfshirë gradimet, transferet, angazhimet e zyrtarëve policorë në detyra të lehtësuara dhe me orar të shkurtuar të punës, pushimet e lehonisë, etj. Mesatarja e qëndrimit në kuadër të sektorëve variron, nuk është e njëjtë dhe kjo dallon nga stacioni në stacion. Në disa stacione nuk ka evidenca të tilla dhe meqë ky standard parashihet të përmbushet në vazhdimësi, mbetet për detyrë që drejtuesit e stacioneve të angazhohen në përmbushjen e një standardi të tillë. Sipas zyrtarëve të intervistuar, qëndrimi i zyrtarëve policor në sektorë sipas standardit të lartëcekur është i pamundur pasi që faktorët e mësipërm ndikojnë në arritjen e standardit të tillë. IPK-ja vlerëson se mosqëndrimi i zyrtarëve policorë në sektor sipas standardit të kërkuar mund të ndikojë në besueshmërinë dhe kënaqshmërinë e publikut me punën policore dhe dobëson bashkëpunimin ndërmjet Policisë dhe komunitetit, gjë që ndikon në efektivitetin dhe efikasitetin policor në ngritjen e sigurisë publike.

Rekomandimi nr. 2

IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonalë dhe Komandantëve të Stacioneve Policore, që në drejtim të ngritjes së besimit dhe bashkëpunimit me komunitetin, të angazhohen në realizimin e standardit të paraparë me Strategjinë dhe Planin e Veprimit 2017-2021 (Policia në Bashkësi), për qëndrimin e zyrtarëve policorë për së paku dy vite në kuadër të sektorëve policorë.

3.1.6. Plani i Veprimit ka përcaktuar lidhur me avansimin e reformave të brendshme, vazhdimin e hapjes së zyrave kontaktuese në kuadër të sektorëve në zonat rurale, me qëllim të përfshirjes së komunitetit në të gjitha nivelet e zgjidhjes së problemeve që ndërlidhen drejtpërdrejtë a tërthorazi me sigurinë e bashkësisë dhe ofrimit të një shërbimi më cilësor nga Policia. Inspektimi i realizuar në stacionet policore të kategorisë A vë në pah se Mitrovicë - Veriu, Pejë, Prishtinë - Jugu, Ferizaj dhe Prizren nuk kanë zyre kontaktuese në kuadër të sektorëve policorë. Drejtuesit e Stacionit Policor në Ferizaj janë në bisedime me Komunën për hapjen e katër (4) zyrave në zonat rurale, për secilin sektor nga një zyre. Prishtinë - Qendra ka një zyre kontaktuese, por nuk është funksionale për shkak të kushteve jo të mira. Stacionet policore që i kanë të hapura zyret kontaktuese në sektorë në zonat rurale janë: Leposaviqi, Gjakova, Mitrovicë - Jugu, Prishtinë - Veriu, të cilat kanë nga tre (3) zyre kontaktuese në kuadër të sektorëve policor. Gjilani ka dy (2) zyre kontaktuese në kuadër të sektorëve. Sipas zyrtarëve të intervistuar të stacioneve, faktorët që kanë ndikuar në moshapjen e zyrave kontaktuese në kuadër të sektorëve në zonat rurale kanë qenë të natyrës organizative, teknike dhe logjistike. IPK-ja vlerëson se moshapja e këtyre zyrave në kuadër të sektorëve në zona rurale është pengesë e përfshirjes së qytetarëve në të gjitha nivelet e zgjidhjes së problemeve që ndërlidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me sigurinë, ofrimin e një shërbimi më cilësor, andaj e shihet të nevojshme hapjen e tyre meqë kjo parashihet në vazhdimësi. IPK inkurajon Drejtorët Rajonalë dhe Komandantët e Stacioneve Policore, që të angazhohen në tejkalimin e vështirësive që kanë penguar hapjen e zyrave kontaktuese në kuadër të sektorëve në zonat rurale, në mënyrë që me hapjen e tyre të ngritin përfshirjen e qytetarëve dhe komunitetit në të gjitha nivelet e zgjidhjes së problemeve që ndërlidhen drejtpërdrejt a tërthorazi me sigurinë dhe ofrimin e një shërbimi më cilësor policor.

3.1.7. Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim ka hartuar Procedurë Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e Policisë së Kosovës për policimin në komunitet (DDO-04/044/2013), që ka për qëllim të ndihmojë në zbatimin e Strategjisë dhe Planin e Veprimit për Policimin në Komunitet, të orientojë policët, udhëheqësit e sektorëve dhe stafin komandues në parandalimin e krimit, duke përdorur kriteret dhe mënyrat e parandalimit të krimit, përcjelljen dhe vlerësimin e trendit të krimit dhe aspekteve tjera të sigurisë në komunitet. Pika 5.3 e Procedurës Standarde të Operimit përcakton që "është e nevojshme që për çdo sektor të instalohet evidencë e posaçme, në të cilën duhet të evidentohen të gjitha informatat që mund të shfrytëzohen për ndërmarrjen e veprimtarisë policore, me qëllim që të ndihmojë në preventivën dhe luftimin e krimit". Pika 7 përcakton se çfarë duhet të përmbajë evidenca sektoriale, përfshirë: informatat mbi pozitën gjeografike të sektorit, evidencën mbi popullësinë në sektor, evidencën mbi krimin në nivel sektori, evidencën mbi komunikimin dhe bashkëpunimin me komunitetin, evidencën për komunikimin e brendshëm me stafin policor nga ai lokal deri në atë qendror. Vlerësohet se në kuadër të sektorëve mbahen dosje sektoriale, por se informatat në to nuk janë në harmoni të plotë me Procedurën Standarde të Operimit, duke i bërë dosjet të jenë me informata jo të plota dhe të mangëta. Mangësitë në dosje sektoriale lidhen më shumë me evidencat për numrin e përgjithshëm të popullatës në sektor, evidencën mbi anëtarësinë e forumeve të sigurisë, evidencën mbi takimet e mbajtura me to, evidencën e personave me të meta mentale dhe psikike, evidencën e fëmijëve bonjak, evidencën e fëmijëve nën përkujdesje të kujdestarisë, evidencën e fëmijëve me prindër të shkurorëzuar, evidencën e personave të kërkuar nga Interpoli dhe Europoli, evidencën e personave në vuajtje të dënimit me burg apo ndonjë masë tjetër ligjore, evidencën e personave me përfundim të burgut/lirim me kusht apo me lirim të

parakohshëm, evidencën e fëmijëve të dhunshëm në familje/shkollë e komunitet në përgjithësi dhe evidentimi i shqetësimeve/brengave/iniciativave e kërkesave tjera lidhur me sigurinë e komunitetit në sektor. Sipas të intervistuarve, moskompletimi i evidencave sektoriale përpos neglizhencës, vjen edhe nga bashkëpunimi jo i mirë në mes të njësive në kuadër të stacionit (Njësia e Hetimeve, Operativës dhe Njësia e Urdhëresave) dhe institucioneve (Gjykatat dhe Komunitat). Mungesa e këtyre të dhënave mund të paraqes një nga pengesat e mundshme në parandalimin dhe luftimin e krimit, si dhe ofrimin e një shërbimi cilësor.

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja u rekomandon Komandantëve të Stacioneve Policore dhe Koordinatorëve të Sektorëve që të angazhohen që evidencat në dosjet sektoriale të kenë informata më të plota dhe të azhurnuara, në përputhje me kërkesat që dalin nga pika 7 e Procedurës Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e Policisë së Kosovës për policimin në komunitet (DDO-04/044/2013), në drejtim të ngritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve nga krimi dhe dukuritë negative, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe ofrimin të një shërbimi më cilësor policor.

3.1.8. Në kuadër të Objektivit strategjik 3 të Planit të Veprimit të Strategjisë mbi bashkërendimin e aktiviteteve të policimit në bashkësi me strategjitë tjera, është përfshirë nënobjektivi 3.1 mbi parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm. Plani i Veprimit ka përcaktuar si aktivitete, krijimin dhe mirëmbajtjen e dosjeve në sektorë mbi personat e dyshimtë që ndërlidhen me ekstremizëm e radikalizëm. Në Prishtinë - Qendra nuk ka ndonjë dosje të veçantë për këtë evidencë, përveç disa veprimeve që janë ndërmarrë në këtë drejtim në takime me Bashkësinë Islame, imamet, Drejtorinë Komunale të Arsimit, që të njoftojnë popullatën për pasojat e kësaj dukurie negative. Në Prishtinë - Veriu janë krijuar gjashtë (6) dosje, janë identifikuar nëntë (9) lokacione dhe janë adresuar nëntë (9) raporte. Prishtinë-Jugu ka identifikuar një person të dyshimtë për radikalizëm dhe ekstremizëm. Në sektorët e Stacionit Policor në Mitrovicë - Jugu ka dosje sektoriale ku në mënyrë specifike ekzistojnë raporte mbi personat e dyshuar. Në Mitrovicë - Veriu është krijuar një (1) dosje për një person. Stacioni Policor - Leposaviq i ka identifikuar dy persona të dyshimtë. Në Stacionin Policor të Pejës mbahet evidencë e tillë nga viti 2016, e cila rifreskohet në baza mujore, apo çdo herë kur pranohen informata, kurse numri i këtyre personave në këtë zonë është 25 dhe prej tyre, disa janë në vatrën e luftës, disa në vuajtje të dënimit, disa në arrest shtëpiak dhe disa në liri. Në Stacionin Policor të Gjakovës nuk ka dosje, por me këtë merret Njësia Qendrore Kundër Terrorizmit që bashkëpunon ngushtë me stacionet policore dhe Njësinë e Inteligjencës. Në Prizren janë nëntë (9) persona të evidentuar si të dyshuar, numri i lokacioneve është 11, numri i raporteve të adresuara për vitin 2017 është dy (2), kurse për vitin 2016 është një (1). Në Ferizaj gjatë vitit 2016 e 2017 janë 23 dosje që janë përcjellur tek Njësia Kundër Terrorizmit. Në Gjilan gjatë vitit 2016 janë identifikuar katër (4) raste dhe në vitin 2017, tre (3) raste. Rastet janë trajtuar nga mekanizmi referues komunal kundër terrorizmit i përbërë nga zyrtarë policor dhe përfaqësues të strukturës komunale, tetë (8) raste janë trajtuar dhe iu ka ofruar mbështetja dhe iu janë rikthyer aktiviteteve jetësore, ndërsa një (1) rast i është referuar Gjykatës. IPK-ja inkurajon stacionet që të angazhohen në vazhdimësi në mirëmbajtjen e dosjeve mbi personat e dyshimtë që ndërlidhen me ekstremizëm e radikalizëm, konform pikës 3.1.1 të Planit Veprimit të Strategjisë 2017-2021.

3.2. Planet policore dhe raportet periodike analitike për sigurinë në komunitet

3.2.1. Të dhënat e derivuara nga inspektimi i raporteve analitike periodike të punës, tregojnë se stacionet konform Ligjit për Policinë dhe strategjive policore, ndërmarrin dhe realizojnë aktivitete operative policore, bazuar në urdhra operativ të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (DPP), plane operative nga drejtoritë rajonale dhe plane vetanake operative. Pikat e kontrollit, patrullimet në këmbë dhe me automjete, asistimet në angazhimet e Gjykatave, Komunave, KEDS-it, Agjencisë së Pronave, Përmbaruesve, etj, janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të stacioneve me qëllim të parandalimit të veprave penale/incidenteve/aksidenteve, mbështetjen e institucioneve, sigurimin e ngjarjeve të ndryshme sportive-kulturore e të ngjajshme. Ka dallim ndërmjet stacioneve sa i përket numrit të planeve e që vjen si rezultat i asaj se të ndryshme janë edhe të dhënat mbi indikatorët e krimit, rrethanat e krijuara dhe nevojat e stacioneve, që luajnë rol në hartimin e planeve operative. Numri i përgjithshëm i planeve të stacioneve të kategorisë A në vitin 2017 ka shënuar rënie të lehtë për 0.7% krahasuar me vitin paraprak. Gjakova dhe Prizreni shquhen me numër më të madh të planeve të hartuara dhe realizuara. Edhe pse i takojnë të njëjtës kategori të stacioneve, Leposaviqi dhe Prishtinë-Veriu shquhen me numër më të ulët të planeve. Në shtatë (7) nga 11 stacione ekziston një trend në ngritje i numrit të planeve, kurse Gjakova e Gjilani kanë shënuar ngritjen më të madhe, derisa Mitrovicë-Jugu, rënie më të madhe. Nga numri i përgjithshëm i planeve në nivel stacionesh të kategorisë A, mesatarisht kanë realizuar rreth 11 plane gjatë një muaj pune. Gjakova ka realizuar mesatarisht rreth 40 plane gjatë një muaji pune, Prizreni pason me rreth 34 plane operative gjatë një muaji pune. Leposaviqi dhe Prishtinë - Veriu kanë realizuar mesatarisht nga një (1) plan në muaj. Është dallim i madh në mes të stacioneve në realizimin e planeve edhe se i takojnë të njëjtës kategori. Inkurajohen drejtuesit e stacioneve që të analizojnë situatën e sigurisë, indikatorët e krimit, nevojat, kapacitetet dhe të vazhdojnë me aktivitete operative në ngritjen e sigurisë publike.

Tabela nr. 2 - Të dhëna statistikore mbi numrin e planeve operative të stacioneve				
Stacionet policore (A)	2016	2017	Krahasimi (+/-)	Mesatarja për muaj
Prishtinë - Qendra	155	140	-15	12
Prishtinë - Veriu	15	16	+1	1
Prishtinë - Jugu	24	40	+16	3
Mitrovicë - Jugu	80	35	-45	3
Mitrovicë - Veriu	20	23	+3	2
Leposaviç	8	15	+7	1
Pejë	164	167	+3	14
Gjakovë	455	480	+25	40
Prizren	423	411	-12	34
Ferizaj	59	44	-15	4
Gjilan	70	92	+22	8
Gjithsej	1.473	1.463	-10	11

3.2.2. Nga analiza e planeve operative dhe raporteve pasoperacionale, shihet se trajtojnë tema që ndërlidhen me ngritjen e sigurisë publike. IPK-ja ka identifikuar një numër planesh operative që lidhen me ngritjen e sigurisë në komunitet, sigurinë në rrugë, transportin ilegal, parandalimin e kryerjes së veprave penale, parandalimin e përdorimit të drogave në shkolla, lëmshë kërkuesit,

realizimin e urdhëresave, ngritjen e sigurisë së komuniteteve pakicë, parandalimin e vjedhjeve, etj. IPK-ja është interesuar të njihet me faktin nëse planet adresojnë problematikat e shfaqura në zonat e përgjegjësi të stacioneve policore. IPK-ja ka vërejtur se planet operative adresojnë problemet e shfaqura nëpër zonat përgjegjëse të këtyre stacioneve. Ndërmarrja e veprimeve operative bazuar në planet e hartuara synon të përmirësojë dhe ngritë sigurinë në komunitet. Përmes aktiviteteve të tilla operative ndikohet në identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve nga krimi dhe dukuritë negative, përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit dhe ofrimin e një shërbimi efikas policor. IPK-ja inkurajon stacionet që të vazhdojnë të nxjerrin plane operative bazuar në vlerësimin e rreziqeve dhe të adresojnë problematikat e identifikuara në zonat e tyre të përgjegjësisë.

3.2.3. Informatat inteligjente të siguruara në rrugë operative paraqesin mjet të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e krimit në shoqëri dhe sa më i madh të jetë numri i tyre, edhe më e madhe është mundësia për trajtim cilësor të aktivitetit kriminal. Policimi në bashkësi bazohet në frymën e bashkëpunimit me komunitetin, ku edhe mund të sigurohen informata mbi aktivitetin kriminal. Procedura Standarde e Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e Policisë së Kosovës për policim në komunitet, në pikën 6.1 ku flitet për detyrat e Komandantit të Stacionit Policor në funksionimin e sektorit, përcakton se “Komandanti i Stacionit është përgjegjës dhe duhet siguruar që ka bashkëpunim të ngushtë dhe nivel të lartë të shkëmbimit të informatave në mes Policit të Inteligjencës dhe policëve të stacionit dhe njërive tjera brenda zonës së përgjegjësisë së stacionit, po ashtu me shefat e sektorëve dhe Koordinatorin e sektorëve”. Stacionet janë të obliguara të kenë të dhëna të sakta mbi trendin e krimit në zonën e përgjegjësisë, planifikimin e aktiviteteve, analizimin e të dhënave/informatave, avancimin e bashkëpunimit me komunitet, institucionet lokale, shoqërinë civile, mediat, partnerët tjerë me qëllim parandalimin e krimit dhe të dukurive të tjera negative që mund të reflektojnë në sigurinë e komunitetit. Procedura Standarde e Operimit për Detyrat e zyrtarit policor në procesin e inteligjencës (ZDPO-02/004/14), në kapitullin VI, pika 2 ku rregullohet bashkëpunimi reciprok, përcakton se “Zyrtari për Inteligjencë e Analizë në kuadër të stacionit policor është kompetent dhe përgjegjës dhe duhet kujdesur që të krijojë bashkëpunim të ngushtë me të gjithë zyrtarët policor në kuadër të Stacionit ku punon. Sasia dhe cilësia e informacioneve të pranuar dhe përpilimi i raporteve të Inteligjencës do të shërbej si matës për nivelin e bashkëpunimit të arritur”.

3.2.4. Stacionet ende praktikojnë raportimin nga terreni përmes C1, si një formë e raportimit të aktiviteteve të dyshimta që nga periudha e administrimit të Policisë së UNMIK-ut. Strategjia-Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca nuk parasheh përdorimin e këtij formulari, njejte sikur edhe Procedura Standarde e Operimit - Detyrat e zyrtarit policor në procesin e inteligjencës. Kjo e fundit përcakton aplikimin e raporteve informuese dhe atyre të inteligjencës 5x5x5. Deri në fund të vitit 2015 dhe fillim të vitit 2016, raportet 5x5x5 janë plotësuar vetëm nga zyrtarët e inteligjencës dhe hetuesit e njërive të hetimeve, por më pas ka qenë dashur të filloj zbatimi i modulit të inteligjencës në kuadër të Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), kështu që të gjithë zyrtarëve policor iu është shpjeguar se forma C1 do të hiqet nga përdorimi dhe do të zëvendësohet me 5x5x5. Raportet 5x5x5 po të plotësoheshin në SIPK, do të përcilleshin automatikisht tek Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë për vlerësim e cila më pastaj do ta shpërndante informatën tek njëria apo stacioni përkatës për veprim, mirëpo plotësimi i raporteve 5x5x5 ende plotësohet manualisht dhe procedura e përcjelljes së raporteve është me sa vijon: nëse raporti është plotësuar nga zyrtarët e stacioneve ato dërgohen direkt apo përmes zyrtarit të inteligjencës së stacionit tek Njësia e

inteligjencës rajonale, e cila e kontrollon dhe e plotëson nëse është e mundur dhe përmes rrjetit të brendshëm e përcjellë në DIA. Ferizaj dhe Prizreni janë stacione policore që shquhen me numrin më të madh të raporteve të inteligjencës 5x5x5 për të dy vitet. Peja, Mitrovicë - Veriu dhe Leposaviqi nuk kanë evidentuar asnjë raport të inteligjencës 5x5x5.

Rekomandimi nr. 4

IPK-ja u rekomandon Komandantëve të Stacioneve Policore që të angazhohen në krijimin e kushteve për aplikimin e raporteve informuese dhe raporteve të inteligjencës mbi ngjarjet dhe veprimet e dyshimta kriminale, konform Strategjisë - Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca dhe Procedurës Standarde të Operimit për Detyrat e Zyrtarit policor në procesin e inteligjencës.


3.2.5. Të gjeturat e inspektimit vëjnë në pah se Zyrtari për Inteligjencë dhe Analizë në stacionet policore, i përzgjedhë dhe analizon përmbajtjen e të gjitha raporteve të inteligjencës që vijnë nga policët patrullues sektorial nga zyrtarët tjerë policor dhe komuniteti në mbështetje të sektorit, të cilat më pas i përcjellë në Njësinë e Inteligjencës Rajonale, e cila ia adreson Drejtorisë për Inteligjencë e Analizë. Informatat u ofrohen njësisive përkatëse me qëllim që të ndërmerren masat policore kundrejt veprave eventuale që ndodhin apo mund të ndodhin. Bashkëpunimi me shefat e sektorëve, koordinatorin e projekteve në komunitet dhe shefin e hetimeve në shpërndarjen e informatave dhe raporteve analitike vërehet dukshëm në stacione policore dhe kjo ndikon në parandalimin e krimit, eliminimin apo zvogëlimin e brengave dhe shqetësimeve të komunitetit për probleme dhe çështje të caktuara e që reflektojnë në situatën e sigurisë në ndonjërin nga sektorët patrullues apo në të gjithë sektorët në nivel stacioni. Inspektimi tregon se stacionet hartojnë raporte analitike, ku paraqesin shtrirjen e veprimtarisë kriminale, identifikimin e pikave të nxehta, kohën, identifikimin e të dyshuarve të vepra kriminale, mënyrën e kryerjes së veprës, në mënyrë që zyrtarët policor në stacionet policore të kenë një pasqyrë më të mirë për planifikimet dhe qasjen në zonat e identifikuar. IPK-ja inkurajon zyrtarët në stacione që të angazhohen më fuqishëm në paraqitjen e informatave të nevojshme në raportet analitike dhe të qasjes në terren, me qëllim të arritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve nga krimi dhe dukuritë negative tjera, drejt përmirësimit të sigurisë publike.

3.2.6. Raportet e përpiluara nga sektorët realizohen pothuajse në çdo stacion, me të dhëna dhe dëshmi të mbledhura dhe të analizuar. Më pas shpërndahen informatat tek njësitë përkatëse në kuadër të stacionit dhe kështu në vazhdimësi këto informata ndihmojnë operativën dhe hetuesinë në përgaditjen e planeve dhe ndërmarrjen e veprimeve operative. Raportet vjetore të stacioneve janë analizuar dhe në përgjithësi informatat përcillen zinxhir në hierarkinë e stacionit. Se sa janë cilësore informatat, tregojnë rezultatet e rasteve hetimore me emëruesin e përbashkët “epilogun” si raste të zbuluara/jo të zbuluara, që ndërlidhë rezultatin e punës hetimore operative. Sipas drejtuesve të stacioneve nuk kanë kurrfarë mundësie stimuluese të qytetarëve në kompensim të informatave “të rëndësishme”. IPK inkurajon drejtuesit e stacioneve që të nxisin bashkëpunimin me komunitetin, në drejtim të sigurimit të informatave cilësore që i kontribuojnë sigurisë publike.

3.3. Performanca e stacioneve policore në ngritjen e sigurisë në komunitet

3.3.1. Plani Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës (2016 - 2020) ka paraparë ‘zvogëlimin e rasteve kriminale dhe rritjen e zbulueshmërisë’ si aktivitet në kuadër të objektivit strategjik ‘Ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë’, nënobjektivi ‘Përmirësimi dhe ruajtja e sigurisë publike, parandalimi dhe zvogëlimi i aktiviteteve kriminale’. Trendet e krimit, dinamika e qarkullimit të njerëzve e mallrave, avancimi teknologjik, vështirësitë e trashëguara nga e kaluara në aspektin e sigurisë, si dhe synimet euro-integruese kanë sjellë në pah nevojën e qytetarëve dhe Policisë që të avancohet partneriteti në mes tyre. Kjo qasje aplikohet për ngritje të cilësisë së jetës dhe sigurisë së komunitetit përmes bashkëpunimit të ndërsjellë. Policia ka avansuar në mënyrën e mbledhjes së të dhënave mbi trendët e krimit dhe kjo bën që periodikisht të maten dhe krahasohen indikatorët e nivelit të krimit, por edhe performanca në parandalimin dhe luftimin e krimit. Rastet, qoftë penale apo incidente në vitin 2017 kanë shënuar rënie për 6.4% krahasuar me vitin paraprak. Zonat e përgjegjësive ku operojnë Prishtinë - Qendra dhe Prishtinë - Jugu mbeten zonat me raste me të shumta të regjistruara gjatë dy (2) viteve. Zonat e përgjegjësive të Mitrovicë - Veriu dhe Leposaviqit kanë regjistruar numrin më të ulët të rasteve përgjatë dy viteve. Përgjatë vitit 2016, në nivel të përgjithshëm të stacioneve policore të kategorisë A është regjistruar një përqindje mesatare e zbulueshmërisë së rasteve në kuotë prej 67.9%. Leposaviqi dhe Prizreni kanë shënuar përqindjen më të lartë të zbulueshmërisë së rasteve (91.9% dhe 73.7%), derisa Mitrovicë - Veriu dhe Prishtinë - Veriu kanë shënuar përqindjen më të ulët të zbulueshmërisë (40.8% dhe 61.8%). Përgjatë vitit 2017, në nivel të stacioneve është regjistruar një përqindje mesatare e zbulueshmërisë së rasteve prej 65%. Këto variabla tregojnë se ka rënë zbulueshmëria e rasteve për 2.9% në krahasim me vitin 2016 edhe pse në vitin 2017 janë regjistruar më pak raste se një vit më parë. Leposaviqi dhe Prizreni në vitin 2017 kanë shënuar përqindjen më të lartë të zbulueshmërisë së rasteve (73.6% dhe 72%), derisa Mitrovicë - Veriu ka shënuar përqindjen më të ulët të zbulueshmërisë (42.2%).

Diagrami 1 - Trendi i veprave penale dhe incidenteve 2016-2017



Rekomandimi nr. 5

IPK-ja u rekomandon Komandantëve të Stacioneve Policore që kanë shënuar rënie të efikasitetit në hetimin dhe zbulimin e rasteve, që të shtojnë përpjekjet në zvogëlimin e numrit të rasteve kriminale dhe ngritjen e shkallës së zbulueshmërisë, konform Planit Zhvillimor Strategjik të Policisë së Kosovës 2016-2020 (objektivi 1, nënobjektivi 1.1, aktiviteti 1.1.1).

3.3.2. Nëse vështrojmë trendin e krimit sipas zonave të përgjegjësive, rënien më të madhe të numrit të rasteve e ka shënuar Prizreni dhe Gjilani ku numri i tyre ka rënë për 15.5%, përkatësisht 8.8% krahasuar me vitin paraprak, kurse ngritjen më të madhe të numrit të rasteve e ka regjistruar Mitrovicë - Veriu dhe Leposaviqi me 12.2% përkatësisht 3.7% krahasuar me vitin paraprak. Ngritjen më të theksuar të përqindjes së zbulueshmërisë së rasteve në vitin 2017 e ka shënuar Peja me 4.5%, derisa uljen më të theksuar të përqindjes së zbulueshmërisë në 2017 e ka regjistruar Leposaviqi me 18.3%. Na pasqyrohen disa indikatorë kontravers, meqë me gjithë rënien e numrit të rasteve, kemi një rënie të zbulueshmërisë dhe se edhe pse këto stacione policore i takojnë të njëjtës kategori, është i ndryshueshëm edhe trendi i krimit. Rënia e zbulueshmërisë konsiderohet të ketë ardhur si pasojë e mungesës së zyrtarëve policor aktiv në terrenet e prekura më së shumti nga veprat e tilla, kushteve të punës, përfshirë automjetet zyrtare. Ajo që paraqet një indikator pozitiv të gjendjes së aktiviteteve hetimore është tendenca e rënies së numrit të rasteve. IPK-ja inkurajon Komandantët e stacioneve dhe drejtuesit e hetimeve dhe operativës që të analizojnë indikatorët e performancës së njësive të tyre policore, drejt identifikimit të faktorëve që kanë ndikuar në rënien e trendit të krimit dhe zbulueshmërisë së rasteve, në mënyrë që të eliminohen mundësitë për mosefikasitet policor, me këtë edhe rrezikimin e sigurisë publike.

3.3.3. IPK-ja ka analizuar edhe llojet e veprave më të shumta që i kanë karakterizuar këto zona të përgjegjësive. Në zonën e përgjegjësive së Prishtinës - Qendra gjatë vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje e rëndë" me 629 raste, krahas atyre të vitit 2017 me 665 raste. Në zonën e përgjegjësive së Prishtinës - Veriu gjatë vitit 2016 dominojnë "Veprat penale kundër pasurisë" me gjithsej 670 raste, krahas atyre të vitit 2017 me 697 raste. Në zonën e përgjegjësive së Prishtinës - Jugu gjatë vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje" me 791 raste, krahas atyre të vitit 2017 me 721 raste. Në zonën e përgjegjësive së Mitrovicës - Jugu gjatë vitit 2016 dominojnë "Veprat penale kundër pasurisë" me 529 raste, krahas atyre të vitit 2017 me 500 raste. Në zonën e përgjegjësive së Mitrovicës - Veriu gjatë vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje" me 77 raste, krahas atyre të vitit 2017 me 71 raste. Në zonën e përgjegjësive së Leposaviqit gjatë vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje" me 25 raste krahas, atyre të vitit 2017 me 18 raste. Në zonën e përgjegjësive së Pejës gjatë vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje" me 520 raste, krahas atyre të vitit 2017 me 410 raste. Në zonën e përgjegjësive së Gjakovës gjatë vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje" me 245 raste, krahas atyre të vitit 2017 me 265 raste. Në zonën e përgjegjësive së Prizrenit vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje" me 460 raste, krahas të vitit 2017 me 377 raste. Në zonën e përgjegjësive së Ferizajt gjatë vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje" me 721 raste, krahas atyre të vitit 2017 me 677 raste. Në zonën e përgjegjësive së Gjilanit gjatë vitit 2016 dominojnë rastet e veprave penale "Vjedhje" me 371 raste, krahas të vitit 2017 me 276 raste. IPK-ja vlerëson se me gjithë trendin në rënie të këtyre rasteve në shumicën e stacioneve policore, duhet të ketë përkushtim të vazhdueshëm policor në reduktimin e tyre, me qëllim të rritjes së sigurisë publike dhe kjo mund të arrihet duke shpeshuar aplikimin e metodave dhe masave parandaluese operative, përfshirë aktivitetet patrulluese. Këto raste të pasqyruara si më të shpeshta duhet të vlejnjë si fakt që stacionet duhet përqendruar në nxjerrjen e planeve operative, që do të adresonin dukuritë evidente.

3.3.4. Në kuadër të Objektivit strategjik 2 të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2017-2021 (Policia në Bashkësi) lidhur me ngritjen e besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me punën policore është përfshirë nënobjektivi 2.2 mbi ndërmarrjen e veprimeve për ngritjen e kënaqshmërisë dhe

besueshmërisë me punën policore. Strategjia ka paraparë aktivitetin 2.2.9 për caktimin e rasteve me prioritet dhe monitorimin e progresit të hetimeve tek këto raste. Plani i Veprimit përcakton që Shefi i Hetimeve të stacionit të bëjë caktimin e rasteve me prioritet dhe në baza periodike të raportojë për zbulimin e tyre. Është parim policor që të gjitha rastet kanë prioritet, mirëpo një numër i tyre janë më me prioritet varësisht nga rëndësia dhe natyra. Tek këto raste ushtrohet mbikëqyrje në hapat e zbulimit të tyre, këtu cekën disa prej tyre: kur të dyshuarit/ve iu caktohet masa e ndalimit policor, veprat penale kundër jetës dhe trupit, kanosjet serioze, dhuna në familje, vrasjet, grabitjet e armatosura, terrorizmi, rrëmbimi, kanosjet ndaj personaliteteve të larta, etj. Hetuesi njofton Prokurorin e Shtetit si dhe hetuesit rajonal, sipas nevojës edhe hetuesit e nivelit qendror, zakonisht caktohet një rreshter nga hetuesia për udhëheqës të rastit dhe koordinim me njësitë tjera. Konform këtij kriteri po ashtu veprojnë edhe stacionet policore duke i dhënë prioritet rasteve. Varësisht nga rajoni, stacionet policore në zonën e përgjegjësisë së tyre që e kanë për të gjitha rastet që trajtohen, ata edhe iu japin prioritet rasteve duke i klasifikuar si raste më me prioritet. IPK-ja nuk ka arritur të sigurojë raporte të monitorimit apo të dhëna statistikore të rasteve të caktuara me prioritet, andaj inkurajohen Komandantët e stacioneve dhe Shefat e Hetimeve të stacioneve që meqë ky aktivitet parashihet të realizohet në vazhdimësi me Planin e Veprimit, të mobilizohen në mbajtjen e evidencave mbi rastet me prioritet bazuar në rëndësinë dhe natyrën e tyre, në drejtim të ngritjes së besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së komunitetit me punën policore.

3.3.5. Kalimi në metodologjinë e re të policimit nënkupton edhe kalimin nga qasja reaktive në atë pro - aktive të policimit. Në drejtim të ngritjes së sigurisë në komunitet, Policia bazuar në ligjin dhe strategjitë e saj lidhur me policimin në bashkësi dhe atë të udhëhequr nga inteligjenca ndërmerr veprime apo masa pro - aktive si pjesë e metodologjisë së veprimeve policore. IPK-ja ka analizuar disa nga masat për të vlerësuar efektin e tyre në siguri rrugore. Në nivel të stacioneve të kategorisë A, numri i përgjithshëm i patrullimeve në këmbë gjatë vitit 2017 është pothuajse në baraspeshë me ato të vitit 2016 (21.096 patrullime për 2016 dhe 20.688 patrullime për 2017) dhe numrin më të madh të tyre për vitin 2016 e ka shënuar Laposaviqi me afro tetë (8) patrullime ditore në nivel stacioni, derisa në vitin 2017 e ka shënuar Gjilani me afro nëntë (9) patrullime ditore. Patrullimet me vetura gjatë vitit 2017 kanë shënuar ngritje për 3.6% (nga 23.579 patrullime për 2016 në 24.421 patrullime për 2017) dhe numrin më të madh të tyre për dy vitet e ka shënuar Peja me afërsisht dhjetë (10) patrullime ditore në nivel stacioni. Pikat e kontrollit kanë shënuar ngritje për 11.1% (nga 22.214 në 24.685). Numrin më të madh të pikave të kontrollit për dy vitet e ka shënuar Ferizaj me afërsisht 12 pika kontrolli gjatë një dite pune për dy vitet ndaras. Ndaj kundërvajtësve në trafik janë shtuar gjodat e shqiptuara për 14.8% (nga 61.743 në 70.912 gjoda trafiku). Në vitin 2016 më së shumti gjoda ka shqiptuar Prizreni me afërsisht 29 gjoda për ditë, derisa në vitin 2017 Prishtinë - Qendra ka shqiptuar afërsisht 30 gjoda gjatë një dite pune. Laposaviqi ka shënuar numrin më të ulët të gjobave për dy vitet, derisa në vitin 2016 ka shqiptuar 0.3 gjoda për ditë, në vitin 2017 ka shqiptuar 0.2 gjoda për ditë. Numri i aksidenteve ka shënuar rënie për 11.6% (nga 6.476 në 5.726). Numri i aksidenteve ka rënë në shumicën e zonave të përgjegjësisë së këtyre stacioneve. Rënie më të theksuar të numrit të aksidenteve e ka shënuar Mitrovicë - Veriu me 42.9%, Prishtinë - Jugu me 21.2% dhe Prizreni me 17.6%. Mitrovicë-Veriu ka intensifikuar masat e nevojshme pro-aktive që ka rezultuar me rënie të numrit të aksidenteve. Rezultati pozitiv i Prishtinë - Jugu dhe Prizrenit duket sikur nuk është rezultat domosdo i masave pro-aktive të ndërmarra, meqë treguesit tregojnë se numri i tyre në shumicën e rasteve ka shënuar rënie. Gjakova ka shënuar rënie të numrit të aksidenteve për 12.1% dhe kjo duket sikur është ndikuar nga masat parandaluese (patrullimet,

pikat e kontrollit dhe gjobat), të cilët kanë shënuar ngritje uniforme. Rënie të numrit të aksidenteve kanë shënuar edhe Gjilani e Peja me 11.6%, Ferizaj me 11.2%, Prishtinë - Veriu me 5.9%, Prishtinë - Qendra me 2.2%. Rënia e numrit të aksidenteve është ndikuar nga efekti i minimum dy nga katër masat e ndërmarra nga stacionet. IPK duke çmuar angazhimet e stacioneve për ngritjen e sigurisë rrugore, i inkurajon ato që në baza periodike të analizojnë masat e ndërmarra pro - aktive në mënyrë që të vërehet efekti i tyre, por edhe duke patur parasysh personelin dhe automjetet e disponueshme. Është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në numrin e ulët të gjobave dhe aksidenteve të trafikut në kuadër të zonës së përgjegjësive të stacioneve të Mitrovicë - Veriu dhe Leposaviqit.

Tabela nr. 3 - Të dhëna statistikore mbi aktivitetet proaktive dhe reaktive policore në ngritjen e sigurisë publike												
Aktiviteti /viti		Prish. Qend.	Prish. Veriu	Prish. Jugu	Mit. Jugu	Mit. Veriu	Lepos	Pejë	Gjak.	Prizr.	Feriz.	Gjilan
Patrullim me vetur	2016	1.246	1.802	2.135	2.730	1.884	718	3.530	1.389	2.720	2.943	2.482
	2017	1.130	1.915	1.762	2.673	2.269	1.808	3.826	1.741	2.258	2.591	2.448
	(+/-) %	-116 -9.3	113 6.3	-373 -17.5	-57 -2.1	385 20.4	1.090 152	296 8.4	352 25.3	-462 -17	-352 -12	-34 -1.4
Patrullim në këmbë	2016	2.820	1.217	1.349	2.510	2.297	2.908	1.150	1.050	1.538	1.599	2.658
	2017	2.866	1.022	1.168	1.659	2.651	3.420	918	1.086	806	1.671	3.421
	(+/-) %	46 1.6	-195 -16.0	-181 -13.4	-851 -33.9	354 15.4	512 17.6	-232 -20.2	36 3.4	-732 -47.6	72 4.5	763 28.7
Pika kontrolli	2016	1.654	1.269	2.143	1.975	2.083	1.700	2.400	641	1.782	4.252	2.315
	2017	1.503	2.231	2.128	1.774	2.589	2.526	2.135	1.755	1.925	4.221	1.898
	(+/-) %	-151 -9.1	962 75.8	-15 -0.7	-201 -10.2	506 24.3	826 48.6	-265 -11	1.114 173.8	143 8	-31 -0.7	-417 -18
Gjoha	2016	7.922	2.613	4.629	4.634	229	108	7.560	6.253	10.736	8.493	8.566
	2017	11.113	3.401	4.633	3.679	182	82	10.928	7.269	10.068	9.475	10.082
	(+/-) %	3.191 40.2	788 30.1	4 0.1	-955 -20.6	-47 -20.5	-26 -24.1	3.368 44.5	1.016 16.2	-668 -6.2	982 11.6	1.516 17.7
Aksident trafiku	2016	1.449	490	1.596	323	7	5	406	198	716	769	517
	2017	1.417	461	1.258	315	4	8	359	174	590	683	457
	(+/-) %	-32 -2.2	-29 -5.9	-338 -21.2	-8 -2.5	-3 -42.9	3 60	-47 -11.6	-24 -12.1	-126 -17.6	-86 -11.2	-60 -11.6

3.3.6. Në kuadër të Objektivit strategjik 1 të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2017-2021 (Policia në Bashkësi) lidhur me fuqizimin dhe avansimin e partneritetit është përfshirë nën objektivi 1.4 mbi ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor. Strategjia ka paraparë aktivitetin e identifikimit të pikave të zeza dhe problemeve në trafik. Në përgjithësi çdo stacion policor sipas detyrës zyrtare raporton dhe njëkohësisht identifikon pikat e zeza si rreziqe potenciale për shkaktimin e aksidenteve më të shpeshta (udhëkryqet, dëmtimet në rrugë, pusetat e hapura në rrugë, mungesa e shenjave të trafikut, shtyllat elektrike përgjatë segmenteve rrugore të zonave përgjegjëse, etj). Këto evidentohen nga Policia dhe adresohen tek organet përgjegjëse. Masat e ndërmarra nga Policia realizohen në formën e inspektimeve apo kontrolleve periodike në rrugë. Nga të gjitha stacionet policore parimisht janë identifikuar pikat e zeza në rrugët e zonave të përgjegjësive dhe analizuar shkaqet e aksidenteve. Sipas stacioneve të inspektuara, rrugët që kanë pika të ndjeshme e që bartin rrezik për sigurinë e trafikut rrugor, janë objekt i patrullimeve dhe pikave të kontrollit policor. IPK çmon angazhimet policore të stacioneve në këtë drejtim dhe inkurajon ato që në vazhdimësi të kryejnë inspektime të rrugëve, të adresojnë shqetësimet tek organet përgjegjëse mbi pikat e zeza, si dhe të hartojnë raporte mbi këto pika, si shkaktar të mundshëm të aksidenteve.

3.3.7. Strategjia dhe Plani i Veprimit parasheh aktivitete me partnerë në organizimin e takimeve koordinuese për ngritjen e sigurisë në rrugë. Personeli përgjegjës i stacioneve në përgjithësi del të jetë i kënaqur me këto aktivitete, sepse pos tjerash kanë detyrim ligjor të veprojnë në interes të qytetarëve, Stacionet nxjerrin plane, realizojnë projekte dhe fushata vetëdijesuese për ngritjen e sigurisë rrugore. Policia mbanë takime të shpeshta sidomos me shkollat fillore dhe të mesme mbi sigurinë në trafik dhe rreziqet nga dukuritë negative. Policia mban ligjërata me qëllim vetëdijesimi të rinjëve mbi trafikun dhe si të mbrohen nga dukuritë negative. Policia po ashtu, viziton edhe shkollat në fshatra. Lidhur me sigurinë rrugore, stacionet shprehin brengat e tyre mbi parkingjet e parregullta në trotuare/rrugë, si dhe rrezikun nga qentë endacak. Vërehen angazhime në mbajtjen e kontakteve me qytetarët, bashkëpunimin me institucionet, drejt vënies nën kontroll të situatës së përgjithshme të sigurisë. Inspektimi ka vënë në pah angazhimet evidente të Njësive të Komunitetit në kuadër të stacioneve policore, që në baza periodike raportojnë mbi planet dhe projektet e realizuara me komunitetin mbi ngritjen e sigurisë rrugore. Janë realizuar projekte mbi sigurinë rrugore, si: shpërndarja e materialeve mbi sigurinë, siguria gjatë sezonës verore, siguria në trafik, edukimi mbi rreziqet, njihuri me policin dhe siguria elementare në trafik, mbajtja e takimeve dhe ushtrimi i kërkesave në dikasteret përkatëse për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme mbi sigurinë në komunikacion, shenjimin e rrugëve, vënien e barrierave të ndryshme mbrojtëse, etj. IPK inkurajon Njësitë e Komunitetit dhe stacionet që të punojnë në vazhdimësi në ngritjen e sigurisë rrugore, përmes nxjerrjes së planeve, projekteve, organizimit të takimeve dhe ligjëratave me fokus grupet.

3.3.8. Plani Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës (2016 - 2020) ka paraparë ‘uljen e kohës së reagimit policor’ si aktivitet në kuadër të objektivit strategjik ‘Ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë’, nënobjektivi ‘Përmirësimi dhe ruajtja e sigurisë publike, parandalimi dhe zvogëlimi i aktiviteteve kriminale’. Vonesat në reagim në rastet kur qytetarët kanë nevojë, ndodhë të vijnë në shprehje gjatë punës së përditshme dhe joefikasiteti në reagim ndaj thirrjeve mund të nxisë vetëgjyqësinë e qytetarëve si metodë që mund ta përdorin për zgjidhjen e problemeve. Policia duhet të ketë më shumë personel efektiv në terren dhe të jetë në dispozicion për çdo nevojë. Sipas komandantëve, të cilët i kanë shprehur brengat e tyre për vonesa të tilla, ndër shkaktarët që kanë ndikim në reagimin e duhur policor janë burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe mungesa e automjeteve. Konceptimi i policimit në bashkësi nënkupton përafrimin qytetar me Policinë, identifikimin e problemeve dhe bashkëpunimin në raportimin e rasteve. Drejtuesit e stacioneve shprehin brengat e tyre gjatë realizimit të detyrave, ngase sfidohen me shumë probleme, me gjithë që qëllim parësor kanë të jenë më afër qytetarit dhe në mbrojtje të tij. Nuk është mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe teknike problem i vetëm, ngase kur kësaj i shtohet edhe angazhimi i stacioneve në aktivitete shtesë të konsideruara si jopolicore, atëherë sfida për policim të duhur vjen në shprehje. Menaxhimi i burimeve ekzistuese njerëzore dhe teknike në raport me detyrat konform Strategjisë së policimit në bashkësi paraqet sfida për drejtuesit e stacioneve. Për t’iu përkushtuar jetësimit të konceptit të policimit në bashkësi, nevojitet që një pjesë e angazhimeve policore të cilësuar si jopolicore, të kryhen nga institucione tjera të natyrës përkatëse. Disa nga angazhimet policore del të jenë brengosëse sepse marrin kohë, si dhe burime. Stacionet janë të angazhuar në sigurimin e prezencës policore në protesta, aksidente, siguri rrugore, realizim të urdhëresave të gjykatave, transport të personave nga pikat kufitare deri në gjykatë, transport të të arrestuarve deri në burgje, asistim për institucione tjera, përfshirë gjykatat, komunat, përmbaruesit privat, përcjellje të ngjarjeve sportive, etj. Angazhimi në asistim të institucioneve publike dhe private jo gjithnjë është i nevojshëm, merr kohë, krijon kosto dhe

tërheqë burime njerëzore, logjistike dhe administrative, gjë e cila ndikon në mospërmbushjen e kënaqshme të punës primare policore. Humbja e kohës në këto aktivitete ndikon në pamundësinë e përmbushjes së detyrave në sektore, kjo bën që shumë detyra në aspekt preventiv dhe zbatim të Strategjisë për Policinë në Bashkësi, Policimit të Udhëhequr nga Inteligjenca dhe strategjive tjera, të mbesin pa u realizuar në nivelin e dëshiruar. Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës, në kapitullin V, neni 36 dhe 37 përcakton bashkëpunimin e Policisë me institucione tjera. Rregullorja përcakton se “Çdo marrëveshjeje të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit fillimisht i paraprin faza e negociimit. Në këtë fazë palët shprehin gatishmërinë e bashkëpunimit me interes të dyanshëm”. Vlerësohet se interesi i dyanshëm nuk po përkon me interesin policor sepse këto marrëveshje përkundrazi prolongojnë dhe pengojnë punën policore. Nevojitet që drejtuesit e stacioneve në koordinim me nivelin qendror, të rishikojnë politikën e angazhimit në këto detyra, ngase dobësojnë efikasitetin, efektivitetin dhe besimin qytetar. Duke krahasuar të dhënat e viteve 2016 - 2017, pasqyrohen asistimet e shumta që i janë bërë institucioneve publike e private, përfshirë komunat, KEDS-i, përmbaruesit privat, etj. Asistimet në nivel të përgjithshëm të stacioneve të kategorisë A kanë shënuar rënie në vitin 2017 për 17.4% (nga 2.739 në 2.261). Peja dhe Ferizaj prijnë me numrin më të madh të asistimeve. Gjashtë (6) nga 11 stacione kanë shënuar rënie në shkallën e realizimit të asistimeve. Lidhur me ekzekutimin e urdhërësive të gjykatave, numri i tyre në vitin 2017 në nivel të përgjithshëm të stacioneve të kategorisë A ka shënuar rënie për 26.2% (nga 22.764 në 16.792). Nëntë (9) nga 11 stacione kanë shkallë më të ulët të ekzekutimit të urdhërësive. Peja dhe Prizreni prijnë me numrin më të madh të tyre, derisa Leposaviqi ka shënuar numrin më të ulët të tyre. Stacionet policore duhet të analizojnë faktorët që kanë ndikuar në rënien e numrit të urdhërësive dhe varësisht nga rezultatet, të ndërmarrin veprimet e nevojshme në drejtim të ngritjes së shkallë së ekzekutimit.

Tabela nr. 4 - Të dhëna statistikore mbi aktivitetet policore në ngritjen e sigurisë së përgjithshme												
Aktiviteti /viti		Prish. Qend.	Prish. Veriu	Prish. Jugu	Mit. Jugu	Mit. Veriu	Lepos	Pejë	Gjak.	Prizr.	Feriz.	Gjilan
Asistime	2016	137	355	368	164	20	71	656	198	231	300	239
	2017	155	16	169	135	35	100	479	204	210	534	224
	%	13.1	-95.5	-54.1	-17.7	15	40.8	-26.9	3.0	-9.1	78	-6.3
Urdhresa	2016	1.444	761	678	319	382	102	6.315	1.792	5.247	2.211	3.513
	2017	971	834	346	234	297	98	6.771	1.020	3.875	1.712	634
	%	-32.7	9.6	-48.9	-26.6	-85	-3.9	7.2	-43.1	-26.1	-22.6	-81.9

3.4. Fuqizimi dhe avancimi i partneritetit me komunitetin

3.4.1. Takimet me drejtoritë komunale të arsimit, këshillat e prindërve dhe përfaqësuesit e tyre lidhur me sigurinë në shkolla, sipas Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Policimit në Bashkësi janë të obligueshme. Aktivitetet 1.1.1 dhe 1.1.2 të Planit përcaktojnë organizimin e takimeve periodike për me sigurinë në shkolla (Drejtoritë Komunale të Arsimit, përfaqësuesit e shkollave, këshillat e prindërve, OJQ - të dhe forumet e sigurisë) dhe organizimin e ligjëratave, debateve dhe fushatave vetëdijësuese në shkolla mbi dukuritë negative. Meqenëse Strategjia është në vitin e parë të implementimit, IPK-ja është fokusuar në aktivitetet policore të vitit 2017 në fushën e sigurisë në shkolla. Janë organizuar takime me akterët strategjik, janë realizuar projekte vetëdijësuese dhe ligjëratat në shkolla mbi dukuritë negative. Stacioni Policor - Leposaviq ka realizuar 19 takime me

institucione arsimore/këshillat e prindërve dhe 24 ligjërata në shkolla. Ferizaj ka realizuar dy (2) takime me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe Këshillin e prindërve, 121 ligjërata dhe gjashtë (6) projekte vetëdijesuese. Gjakova ka realizuar tre (3) projekte vetëdijesuese, 13 ligjërata dhe 174 vizita në shkolla. Gjlani ka realizuar 40 takime me Drejtorinë Komunale të Arsimit, mbi 150 takime me përfaqësues shkollash/këshillash dhe 50 ligjërata. Mitrovicë - Jugu ka realizuar pesë (5) projekte vetëdijesimi dhe 30 ligjërata. Prishtinë - Jugu ka realizuar gjashtë (6) projekte dhe fushata vetëdijesimi dhe 39 ligjërata. Peja ka realizuar 548 takime me institucione arsimore. Prizreni ka realizuar 548 vizita shkollore, 72 takime me DKA-në/përfaqësues shkollash/këshill të prindërve, gjashtë (6) organizime dhe tetë (8) ligjërata. Prishtinë - Qendra ka realizuar pesë (5) takime me institucionet arsimore dhe tetë (8) projekte vetëdijesimi. Mitrovicë - Veriu ka realizuar nëntë (9) takime me institucione shkollore dhe 11 ligjërata. Prishtinë - Veriu ka realizuar nëntë (9) takime me institucione shkollore dhe përfaqësues shkollash dhe prindërish, 351 vizita, katër (4) projekte vetëdijesimi, 26 ligjërata dhe dy (2) debate. Realizimi i aktiviteteve policore me akterët e cekur mbi sigurinë në shkolla vlerësohet i kënaqshëm dhe pasqyrohet të jetë në ngritje. Sipas drejtuesve, realizimi i projekteve vetëdijesuese edukative mbi parandalimin e dukurive negative në shkolla, trajtimi i çështjeve të sigurisë rrugore për nxënës, vizitat në shkolla dhe takimet me drejtorë shkollash nga Njësia e Komunitetit, është duke ndikuar në vetëdijesimin mbi rreziqet nga dukuritë negative dhe uljen e rasteve. IPK-ja në të ardhmen do të inspektojë përmbushjen e obligimeve strategjike, duke matur performancën e stacioneve në fuqizimin e partneritetit me komunitet, përfshirë edhe ngritjen e sigurisë në shkolla. IPK-ja inkurajon stacionet që të vazhdojnë edhe në të ardhmen me projekte të tilla, ngase ato paraqesin mundësi senzibilizimi dhe njoftimi mbi sigurinë dhe rreziqet nga dukuritë negative.

3.4.2. Plani i Veprimit të Strategjisë ka përcaktuar që në drejtim të ngritjes së sigurisë në shkolla, të realizohen takime, vizita, ligjërata dhe projekte vetëdijesimi mbi dukuritë negative. Realizimi i këtyre aktiviteteve kërkon kuadro që duhet të jenë në gjendje të realizojnë ligjëratat në shkolla. Aktiviteti 1.1.3 i Planit ka përcaktuar organizimin e trajnimeve për trajnerë në nivel lokal për të ligjëruar në shkolla. Sipas Strategjisë, fokus i veçantë i është dhënë organizimit të trajnimeve të ndryshme për shkak të gamës së gjërë të sfidave të policimit. Trajnimet janë të detyrueshme pasi që zyrtarët policor duhet të jenë të trajnuar dhe të aftë për të trajtuar shumëllojshmëri të sfidave, përfshirë terrorizmin, zhvillimin teknologjik, emigrimin, ndryshimet legjislative, etj. Diku rreth gjysma e stacioneve të kategorisë A (Prishtinë - Veriu, Prishtinë - Jugu, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan) nuk kanë trajnerë të trajnuar për ligjërime në fushën e policimit në bashkësi, Prishtinë - Qendra ka vetëm një (1) trajner, Peja ka dy (2) trajnerë, Prizreni ka dy (2) trajnerë, Leposaviq ka vetëm një (1) trajner, Mitrovicë - Veriu ka dy (2) trajnerë, të cilët nuk kanë pasur trajnime, Mitrovicë - Jugu ka dy (2) trajnerë, mirëpo edhe këta që janë, nuk janë të mjaftueshëm për ligjërime të konceptit të Policimit në Bashkësi. Sa i përket trajnimeve të brendshme rreth Strategjisë dhe Planit të Veprimit, disa nga trajnimet e kryera që në fokus kanë komunitetin, janë: “Besueshmëria dhe kënaqshmëria e publikut me Policinë e Kosovës”, “Kursi i avancimit për Policinë e orientuar ndaj komunitetit dhe zgjidhjes së problemit”, “Krijimi i partneritetit në bashkësi”, “Policimi në komunitet”, “Trajnimi për Këshilla Lokale dhe Siguri Publike”. Edhe këto nuk janë të nivelit të kënaqur, sepse nga tematikat që i ka Policia, në veçanti Njësia e Policisë në Bashkësi, u duhet më tej bashkërisht bashkëpunim më i thellë me Divizionin e Trajnimeve, që të krijojnë programe konform trajnimeve të nevojshme karshi zhvillimeve të dukurive negative për këtë njësi, në mënyrë që Policia të jetë e aftë për të praktikuar shumëllojshmëri të sfidave.

Rekomandimi nr. 6

IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Divizionit të Trajnimeve dhe Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Parandalim që të realizojnë trajnime për trajnerë dhe të rrisin gamën e trajnimeve në fushën e policimit, konform Planit të Veprimit të Strategjisë (Policia në Bashkësi) 2017-2021 si dhe përgjegjësi që dalin nga Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës (nenet 91, 92 dhe 93).

3.4.3. Procedura Standarde e Operimit - Veprimtaria në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit (2012-2016) dhe Metodologjinë e Policisë së Kosovës për Policim në Komunitet (DDO-04/044/2013), në kapitullin VI, pika 6.1 përcakton se “Komandanti i Stacionit Policor ndërton dhe avanco bashkëpunimin me forumet për siguri publike, shoqërinë civile, mediat lokale dhe komunitetin”. Po ashtu, ky kapitull përcakton se “Komandanti i stacionit policor është përgjegjës për përkrahje, këshillim dhe avancim të bashkëpunimit me forumet e sigurisë e në veçanti me KLSP-të, me qëllim të rritjes së funksionalitetit të veprimtarisë së tyre”. Sipas Planit të Veprimit, në pikën 1.2.3 parashihet aktiviteti mbi themelimin e Këshillave Lokale për Siguri Publike (KLSP), rifreskimin, ngritjen e pjesëmarrjes së gruas dhe të rinjve dhe trajnimin e tyre. Vlerësohet se gjendja e përgjithshme e funksionimit të KLSP-ve është jo e kënaqshme. Sipas komandantëve, stacionet e kategorisë A i kanë së paku nga dy (2) KLSP të themeluara dhe disa nga stacionet kanë nevojë për KLSP të reja, andaj edhe kanë bërë kërkesa për formimin e tyre në zonat e përgjegjësi. Prishtinë - Veriu dhe Prishtinë - Jugu kanë nevojë për KLSP të reja. Prishtinë - Veriu ka bërë kërkesë për themelimin e një KLSP-je të re në Slivovë dhe për tre (3) vjet rresht ende nuk është formuar. Edhe Prishtinë - Jugu në kuadër të Sektorit të lagjes Ulpiana ka bërë kërkesë për themelimin e një KLSP-je. Prishtinë - Qendra ka dy KLSP. Në Prizren e Pejë përveç KLSP-ve, funksionojnë edhe KKSBB-të dhe EVSB-të. Prizreni ka parashtruar kërkesë për themelimin e një KLSP-je në Zhur. Gjakova dhe Gjiçani kanë nga tre (3) KLSP. Mitrovicë - Jugu ka katër (4), Ferizaj përveç dy KLSP - ve ekzistuese, ende nuk ka aktivizuar asnjë të re. Sipas drejtuesve të stacioneve është problematike çështja e funksionimit të KLSP-ve sepse puna e tyre nuk po kompensohet, duke bërë që të bie interesimi për punë vullnetare. Në zonën e përgjegjësisë së Mitrovicë - Veriu edhe gjatë vitit 2017 nuk janë themeluar KLSP- të për dy sektorët e stacionit dhe nga katër (4) sektorë, vetëm dy nga ato i kanë funksionale këto forume. Interesimi për funksionim të KLSP - ve është i ulët nga anëtarët e tyre. Stacionet duhet të krijojnë raportim standard rreth aktiviteteve që i përkasin fuqizimit dhe avansimit të partneritetit me qytetarët, institucionet dhe forumet e sigurisë, si dhe të identifikojnë ngritjen e pjesëmarrjes së gruas e të rinjëve konform Strategjisë - Planit të Veprimit.

Rekomandimi nr. 7

IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve që në bashkëpunim me komunitetin të shqyrtojnë të gjitha kërkesat për themelimin e Këshillave Lokale për Siguri Publike për ato zona të përgjegjësisë së stacioneve që kanë nevojë dhe varësisht nga mundësitë objektive dhe subjektive, konform Ligjit për Policinë dhe akteve tjera në fuqi.

3.4.4. Në kuadër të nënobjektivit 1.2 (Fuqizimi dhe avansimi i partneritetit me forumet e sigurisë, OJQ-të, mediat dhe organizatat tjera që trajtojnë problemet e sigurisë në bashkësi) është paraparë me Plan të Veprimit, aktiviteti 1.2.1 lidhur me organizimin e takimeve, tryezave dhe seminareve me KLSP-të. Mbajtja e takimeve dhe angazhimi me akterë relevant kanë dhënë rezultat pozitiv në bashkëpunimin e ndërsjellë, qëllimi primar i të cilave është krijimi i një mjedisi të sigurtë dhe më

të qetë në interes të sigurisë së përgjithshme. Organizimi i takimeve, tryezave dhe seminareve me KLSP-të kanë qëllim zgjidhjen e problemeve dhe shqetësimeve të banorëve të zonës. Gjatë vitit 2017, Mitrovicë - Jugu, Mitrovicë - Veriu, Gjilani dhe Prishtinë - Veriu kanë realizuar aktivitete më të theksuara në këtë drejtim. Mitrovicë - Jugu ka realizuar 20 takime me KLSP-të, Mitrovicë - Veriu (18 takime), Gjilani (18), Prishtinë - Veriu (17), e kështu me radhë. Stacionet policore inkurajohen që të konsolidojnë bashkëpunimin me KLSP, përkundër vështirësive dhe interesimit jo të kënaqshëm të anëtarëve të tyre përshkak të pamundësisë së stimulimit të tyre për të kontribuar në ngritjen e bashkëpunimit.

3.5. Kushtet teknike dhe logjistike në stacione policore

3.5.1. Në Procedurë Standarde të Operimit-Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e PK-së për Policim në Komunitet (DDO-04/044/2013), në kapitullin V ku flitet për implementimin e punës sektoriale, në pikën 5.5 përcaktohet se “me qëllim të arritjes së objektivave është obligativ trajnimi i stafit policor për aktivitetet në sektorë, alokimi i mjeteve të logjistikës (vetura, zyra dhe pajisje të tjera për zyrë, çanta për mjetet themelore të punës në sektor jashtë zyrës, etj). Kushtet për punë të zyrtarëve policorë të ndarë në sektorë vlerësohet se u mungojnë të gjitha stacioneve policore, me dallime të pakta nga njëra - tjetra. Së pari, stacionet kanë nevojë për hapësirë të mjaftueshme për punë, së paku nga një zyre për sektorë, u mungojnë pajisjet (kompjuterë, printerë, lap-top, telefona celular zyrtar, aparate fotografike, laserë për matjen e shpejtësisë, alkooteste, shirita për vendngjarje, kona, etj). Në të gjitha stacionet, me përjashtim të Mitrovicë - Jugu që ka një gjendje më të kënaqshme, ballafaqohen me një gjendje të rëndë lidhur me ambientet dhe kushtet e punës. Në Prishtinë - Qendra mungojnë zyrat për sektorë dhe nevojiten së paku edhe dy zyre tjera, kanë probleme me kompjuterët e vjetërsuar, u mungojnë lap topët, telefonat celular zyrtar, foto-kamerat, etj. Në Prishtinë - Veriu ka mungesë të hapësirave për punë, objekti i këtij stacioni policor as për së afërmi nuk plotëson kushtet elementare të punës, mungojnë pajisjet e ndryshme, etj. Në Prishtinë - Jugu, Njësia e sektorëve i ka katër (4) zyre në objektin e stacionit, ka nevojë për zëvendësim të kompjuterëve të vjetërsuar, printer dhe për pajisje tjera. Në Mitrovicë - Jugu është gjendje e mirë sa i përket kushteve të punës dhe pajisjeve të nevojshme për zyrtarët policor që janë duke punuar në sektorë, por ka nevojë për lap top dhe projektor, që janë të nevojshëm për përdorim nga sektorët dhe për nevoja të stacionit. Në Pejë, Njësia e sektorëve ka një zyrë të madhe të përbashkët dhe një zyrë të Koordinatorit të sektorëve, të përbashkët me Koordinatorin e komunitetit, kanë tre kompjuterë, nuk kanë aparat për fotografim, laser për matjen e shpejtësisë, alko-test, lap top e pajisje tjera. Gjakova është furnizuar mjaftueshëm me pajisje, përveç që i mungon alko-testi. Prizreni përbëhet nga gjashtë (6) sektorë, dy (2) nga ta janë nënstacione (Zhur dhe Sreckë), ndërsa katër (4) tjera posedojnë nga një (1) zyre në objektin e Stacionit Policor të Prizrenit, kanë kompjuterë të vjetërsuar dhe funksionojnë me vështirësi, kështu që zyrtarët e sektorëve janë të detyruar të shkojnë në njësi tjera për të përfunduar rastet e tyre, u mungon edhe aparati fotografik, etj. Në Ferizaj, Njësia e sektorëve brenda stacionit ka dy (2) zyre, ka nevojë edhe për dy të tjera, Komuna i ka premtuar hapjen edhe të katër (4) zyreve tjera, për secilin sektor nga një zyre. Pos kësaj, nuk kanë lap top, radar dhe alko-test, aparat për fotografim. Gjilani, veç dy zyreve të vogla dhe dy kompjuterëve, nuk ka pajisje tjera që lehtësojnë përmbushjen e detyrave në sektor. Është e domosdoshme që këtyre zyrtarëve policorë t’iu krijohen hapësira për punë, t’iu përmirësohet gjendja me pajisje, të furnizohen me pajisje që nuk i kanë dhe

ato të vjetërsuara t'iu zëvendësohen me të reja. Mungesa e kushteve ndikon negativisht në kryerjen e detyrave, motivimin e zyrtarëve dhe shkakton rënien e efikasitetit dhe efektivitetit të punës.

Rekomandimi nr. 8

IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse, Drejtorëve Rajonal dhe Komandantëve të stacioneve policore, që të krijojnë kushte pune për zyrtarët policor në punë sektoriale dhe në njësi tjera të stacioneve policore, përfshirë sigurimin e hapësirave të punës dhe pajisjen me mjete apo pajisje të nevojshme pune, konform Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës (nenet 135, 136, 180, 182) dhe Procedurën Standarde të Operimit-Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë për Policim në Komunitet, kapitulli V - Implementimi i punës sektoriale).

3.5.2. Mbështetja e sektorëve me automjete për patrullim është e domosdoshme për punë efikase. Inspektimi vë në pah mungesë të përgjithshme të automjeteve dhe kjo vërehet pothuajse në të gjithë stacionet, në përjashtim të Mitrovicë - Jugu dhe Pejës që kanë një gjendje më të kënaqshme. Mungesa e automjeteve dhe përfshirja e tyre në riparime për kohë të gjatë po paraqet në vazhdimësi pengesë në punën policore. Prishtinë - Qendra ka shtatë (7) automjete në funksion, derisa dhjetë (10) të tjera gjenden në servis për një periudhë të gjatë. Prishtinë - Veriu ka gjashtë (6) automjete në funksion dhe 30 të tjera në servis. Stacionit Policor në Prishtinë - Jugu shpesh i vështirësohet kryerja e detyrave në mungesë të automjeteve, si vizitat e institucioneve, takimet me OJQ, grupet e biznesit, kulturës dhe sportit, etj. Mitrovicë - Jugu ka automjete të mjaftueshme për përdorim nga sektorët. Peja ka gjendjen e kënaqshme me automjete. Gjakova ka 16 automjete, gjysma e të cilave janë në funksion, por me gjendje jo të mirë teknike. Edhe Prizreni dhe Gjlani kanë mungesë të tyre. Ferizaj ka dy automjete dhe vërehet mungesë e tyre. Mungesa e automjeteve është një temë e kahershme dhe kjo gjendje vie përshkak të vjetërsisë së tyre, moskujdesit ndaj tyre, procedurave të riparimit, e faktorëve tjerë. Mungesa e automjeteve ndikon negativisht në performancë dhe kjo nuk i kontribuon ngritjes së besimit të komunitetit, luftimit të krimit dhe sigurisë publike.

Rekomandimi nr. 9

IPK-ja u rekomandon Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorit të Drejtorisë së Logjistikës, Drejtorëve Rajonalë dhe Komandantëve të stacioneve, që të sigurojnë automjete të mjaftueshme për punë sektoriale dhe njësi të tjera të stacioneve, në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme pro-aktive dhe reaktive në krijimin e një ambienti më të sigurtë, fuqizimin e partneritetit me qytetarë, forumet e sigurisë institucionet, OJQ-të dhe mediat

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 12.02.2019, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonal dhe Komandantëve të Stacioneve të kategorisë A, që të angazhohen fuqishëm në harmonizimin e numrit të personelit për punë sektoriale me Listen e Autorizuar të Personelit dhe në gjetjen e mundësive të mosangazhimit të personelit në aktivitete jopolicore, që me vendime janë përcaktuar për punë në sektorë, me qëllim që sektorët policorë të jenë më efikas dhe më efektiv në përmbushjen e synimeve strategjike të policimit.</i>	II (I mesëm)	<i>Ky rekomandim qëndron, por Struktura organizative Policore është në fazën e ndryshimeve ashtu që Drejtorët Rajonal dhe Komandantët e Stacioneve Policore do të veprojnë në përputhje me strukturën e re.</i>	<i>Dhjetor 2019</i>
2.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorëve Rajonalë dhe Komandantëve të Stacioneve Policore, që në drejtim të ngritjes së besimit dhe bashkëpunimit me komunitetin, të angazhohen në realizimin e standardit të paraparë me Strategjinë dhe Planin e Veprimit 2017-2021 (Policia në Bashkësi), për qëndrimin e zyrtarëve policorë për së paku dy vite në kuadër të sektorëve policorë.</i>	II (I mesëm)	<i>Struktura organizative Policore është në fazën e ndryshimeve ashtu që Komandantët e SP-ve do të veprojnë në përputhje me strukturën.</i>	<i>Dhjetor 2019</i>
3.	<i>IPK-ja u rekomandon Komandantëve të Stacioneve Policore dhe Koordinatorëve të Sektorëve që të angazhohen që evidencat në dosjet sektoriale të kenë informata më të plota dhe të azhuruara, në përputhje me kërkesat që dalin nga pika 7 e Procedurës Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e Policisë së Kosovës për policimin në komunitet (DDO-04/044/2013), në drejtim të ngritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve nga krimi dhe dukuritë negative, për të përmirësuar cilësinë e</i>	II (I mesëm)	<i>Ky rekomandim qëndron andaj azhurnimi i dosjeve sektoriale është detyrë e përditshme e Koordinatorëve, Sektorëve nën mbikëqyrjen e Komandantëve të SP-ve.</i>	<i>Qershor 2019</i>

	<i>jetës dhe ofrimit të një shërbimi më cilësor policor.</i>			
4.	<i>IPK-ja u rekomandon Komandantëve të stacioneve policore që të angazhohen në krijimin e kushteve për aplikimin e raporteve informuese dhe raporteve të inteligjencës mbi ngjarjet dhe veprimet e dyshimta kriminale, konform Strategjisë - Policia e Udhëhequr nga Inteligenca dhe Procedurës Standarde të Operimit për Detyrat e Zyrtarit policor në procesin e inteligjencës.</i>	<i>II (I mesëm)</i>	<i>Ky rekomandim qëndron. Komandantët e SP-ve menjëherë duhet të ndërmarrin veprime që të respektohen PSO-të: Policia e Udhëhequr nga Inteligenca; dhe Detyrat e zyrtarit policor në procesin e Inteligjencës</i>	<i>Qershor 2019</i>
5.	<i>IPK-ja u rekomandon Komandantëve të stacioneve policore që kanë shënuar rënie të efikasitetit në hetimin dhe zbulimin e rasteve, që të shtojnë përpjekjet në zvogëlimin e numrit të rasteve kriminale dhe ngritjen e shkallës së zbulueshmërisë, konform Planit Zhvillimor Strategjik të Policisë së Kosovës 2016-2020 (objektivi 1, nënobjektivi 1.1, aktiviteti 1.1.1).</i>	<i>II (I mesëm)</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Komandantët e SP-ve duhet të krijojnë kushte përmes mbikëqyrjes dhe monitorimit të sektorit të hetimeve dhe sektorëve patrullues të rrisë shkallën e zbulueshmërisë së veprave penale si dhe të koordinimit dhe bashkëpunimit me qytetarët në sektor patrullues të zgjidhin probleme të sigurisë dhe të ndikojnë uljen frikës nga krimi e që në të njëjtën kohë do të ndikohet në rënien e numrit të rasteve.</i>	<i>Mars 2019</i>
6.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Divizionit të Trajnimeve dhe Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Parandalim që të realizojnë trajnime për trajnerë dhe të rrisin gamën e trajnimeve në fushën e policimit, konform Planit të Veprimit të Strategjisë (Policia në Bashkësi) 2017-2021 si dhe përgjegjësive që dalin nga Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës (nenet 91, 92 dhe 93).</i>	<i>II (I mesëm)</i>	<i>Ky rekomandim qëndron. Komandantët e SP-ve dhe Administrata rajonale e DRP-ve do të kërkojnë nga Divizioni i trajnimeve që organizojnë trajnime për trajner në fushën e Policimit në Bashkësi për nevojat e trajnimit në nivel DRP-ve.</i>	<i>Dhjetor 2019</i>
7.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve që në bashkëpunim me komunitetin të shqyrtojnë të gjitha kërkesat për themelimin e Këshillave Lokale për Siguri Publike për ato zona të përgjegjësive së stacioneve që kanë nevojë dhe varësisht nga mundësitë</i>	<i>II (I mesëm)</i>	<i>Ky rekomandim qëndron. Komandantët e SP-ve konform përgjegjësisë që kanë si dhe duke u bazuar në kërkesat nga Sektori i Forumeve të Sigurisë /DPBP/menjëherë do të fillojnë me identifikimin e</i>	<i>Qershor 2019</i>

	<i>objektive dhe subjektive, konform Ligjit për Policinë dhe akteve tjera në fuqi.</i>		<i>nevojave për themelim të KLSP-ve të reja me theks të veçantë në ato komuna ku nuk ka të themeluar asnjë KLSP-ë (Suharekë, Deçan, etj).</i>	
8.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse, Drejtorëve Rajonal dhe Komandantëve të stacioneve policore, që të krijojnë kushte pune për zyrtarët policor në punë sektoriale dhe në njësi tjera të stacioneve policore, përfshirë sigurimin e hapësirave të punës dhe pajisjen me mjete apo pajisje të nevojshme pune, konform Rregullores për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës (nenet 135, 136, 180, 182) dhe Procedurën Standarde të Operimit-Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë për Policim në Komunitet, kapitulli V - Implementimi i punës sektoriale).</i>	<i>II (I mesëm)</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Komandantët e SP-ve të fillojnë menjëherë të identifikojnë nevojat logjistike elementare të funksionimit normal të punës në sektorë patrullues dhe përmes zingjirit komandues të i përcjellin në DRP, kurse DRP-ja të përcjell te Departamenti për Shërbime Mbështetëse të PK-së.</i>	<i>Dhjetor 2019</i>
9.	<i>IPK-ja u rekomandon Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorit të Drejtorisë së Logjistikës, Drejtorëve Rajonalë dhe Komandantëve të stacioneve, që të sigurojnë automjete të mjaftueshme për punë sektoriale dhe njësi të tjera të stacioneve, në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme pro-aktive dhe reaktive në krijimin e një ambienti më të sigurtë, fuqizimin e partneritetit me qytetarë, forumet e sigurisë institucionet, OJQ-të dhe mediat</i>	<i>II (I mesëm)</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Autoritet mbështetëse logjistike të të gjitha niveleve do të fillojnë të identifikojnë nevojat për vetura në nivele të sektorëve patrullues dhe në të njëjtën kohë të rishikohen mundësit që ato ekzistuese të shfrytëzohen në mënyrë më racionale për punë në komunitetet duke ndihmuar fuqizimin e punës me partneritet me qytetarët dhe forumet e sigurisë për një siguri më të mirë për të gjithë.</i>	<i>Qershor 2019</i>